



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

(i mbajtur me shënime dhe në mënyrë të përmbledhur)

Tiranë, më 18.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektrezolutës “Për reformën e politikës së jashtme për diasporën”.
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Evis Kushi, Klajda Gjoshaj, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Nard Ndoka, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti dhe Rudina Hajdari,

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klevis Balliu dhe Edi Paloka.

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme.

Sot në rendin e ditës kemi diskutimin dhe shqyrtimin e projektrezolutës “Për reformën e politikës së jashtme për diasporën”. Mendoj se kjo projektrezolutë ka një rëndësi të veçantë. Shpresoj që, pas miratimit të ligjit për diasporën, ligjit “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, si dhe ligjit “Për fondin e zhvillimit të diasporës”, kjo veprimtari shtetërore do të konsiderohet tashmë si një fushë me rëndësi krejt të veçantë, e cila, sigurisht, bashkon përgjegjësitë e shtetit shqiptar, por jo vetëm, me përgjegjësitë e çdo qytetari të Republikës Shqipërisë me bashkëkombësit jashtë atdheut për t’u dhënë atyre më shumë të drejta lidhur me përfaqësimin e tyre, mënyrën se si ata mund t’i japin votëbesim një force politike, me qëllimin për të hapur një kapitull, të cilin, për fat të keq, në këta 27 vjet nuk e kanë pasur, pra pasjen e një zëri aktiv, sigurisht, duke e konsideruar si një prej arritjeve më të mira jo vetëm në proceset tona integruese, por edhe të shtetformimit, si shteti dhe vendi i parë i tyre ku do të që ata ndodhen. Ndaj, duke e konsideruar këtë si një moment të veçantë dhe të rëndësishëm, dua ta përgëzoj ministrin e Shtetit për Diasporës, zotin Majko, për gjithçka që ka bërë deri tani! Njëkohësisht, dua të falënderoj Komisionin për Politikën e Jashtme në përgjithësi, në mënyrë të veçantë nënkomisionin për diasporës, lidhur me punën që kanë bërë për përmirësimin e kësaj projektrezolute!

Nga ana tjetër, një falënderim i veçantë i shkon koleges Bushka, për punën e palodhshme për konsolidimin e këtij dokumenti!

Faleminderit, zoti Majko, që jeni këtu!

Urdhëroni!

Pandeli Majko – Unë ju përgëzoj në mënyrë të veçantë, pasi është një mbledhje shumë serioze, në funksion të legjislacionit që është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Dua të nënvizoj faktin se rezoluta përmbledh të gjitha faktet që ju i dini, të cilat janë krijuar në një kohë shumë të shkurtër. Sidomos për sa i përket punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore, që ka të bëjë me të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Mendoj se ngrihen njëfarë problemesh me rëndësi të veçantë. Ka edhe kërkesa, të cilave unë shpresoj që tu jepet zgjidhje.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Ju kërkoj ndjesë, sot, për fat të keq, sistemi nuk punon, punon vetëm diktofoni

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, rezoluta është një dokument i hartuar në bazë të propozimit të ardhur nga Nënkomisioni i Diasporës në konsultim edhe me kolegë të tjerë të këtij komisioni, siç edhe ju jeni në dijeni. Ne kemi përshtatur ato qëllime dhe objektiva që ka vetë komisioni, në kuadër të tagrit të tij për sa i takon ndjekjes së zbatimit të legjislacionit.

Kështu që mendoj se rezoluta përfaqëson qartë të gjithë përpjekjet e bëra dera deri në këtë moment për sa u takon lidhjeve reale dhe konkrete të bashkombësive tanë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe shpreh angazhimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të kryer të gjitha detyrat e tij, madje edhe më tej, në mënyrë që gjithçka që duhet bërë për integrimin e bashkëkombësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku theksoj si më të rëndësishme të drejtën e tyre për të votuar dhe të drejtën e tyre për të qenë pjesë e jetës sociale ekonomike të vendit, tashmë janë të përfshira në rezolutë. Kështu që mua nuk më ngelet gjë tjetër, veçse të falënderoj të gjithë kolegët dhe ministrin Majko për punën që kanë bërë dhe i ftoj ta miratojnë këtë projektrezolutë!

Mimi Kodheli – Sigurisht, rezoluta është një fjalë madhe dhe një impenjim i rëndësishëm i qeverisë dhe i parlamentit, me qëllim ngritjen e këtyre objektivave. Dua të ritheksoj edhe njëherë nevojën jo vetëm të të drejtës së votës të shtetasve jashtë vendit, por dhe të mekanizmit ligjor që këtë të drejtë e çon te çdo shtetas, formulën dhe, njëkohësisht, mundësinë e atij modeli që të jetë sa më efikas, por edhe që të kushtojë më pak. Pavarësisht se krijohet ideja sikur jemi në mbyllje të sesionit parlamentar, në shtator qeveria do të vijë me projektbuxhetin e vitit që vjen. Besoni se në vitin që vjen fondet që do t'i akordohen ministrisë suaj do të jenë të mjaftueshme në rakordim me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Jashtme për të mundësuar këtë gjë? E di që Kodi Zgjedhor nuk është bërë ende, e di që ka shumë punë për të shkuar deri te modeli, modele në Europën Perëndimore ka shumë, por shpresoj shumë që të bëhet. Duhet të ndryshohet Kodi Zgjedhor, i cili për t'u ndryshuar sigurisht që duhet të ketë konsensus politik. Pra, janë një sërë gjërash, që e bëjnë këtë rezolutë të vështirë për t'u zbatuar, por absolutisht të domosdoshme për të mbërritur.

Si e mendoni të ardhmen e votës së diasporës, por jo vetëm, edhe shtimin e të drejtave të tyre, vlerave për t'u përfaqësuar e kështu me radhë, për të funksionuar agjencia, për të funksionuar ligji e të tjerë?

Pandeli Majko – Faleminderit për pyetjen!

Kjo është një nga shqyrtimet më të bukura që ne kemi diskutuar jo vetëm brenda strukturave të qeverisë, por edhe me strukturat e tjera. Gjithsesi, ky është një vendim që i takon Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe pa diskutim përbën një nga reformat më të rëndësishme, pas reformës në drejtësi, në bazë të Kushtetutës. Ne pranë Komisionit për Reformën Zgjedhore kemi depozituar një dokument me të gjitha modelet ekzistuese, që funksionojnë aktualisht në Europë. Dua të them se ky është një vendim që në fund fare i takon Komisionit të Reformës Zgjedhore. Pse e them këtë? E them jo vetëm nga pikëpamja ligjore, por ne nuk mund të hedhim asnjë hap për të drejtën e votës së shtetasve pa votën e opozitës. Pra, kërkon një konsensus shumë të gjerë, pasi, për disa arsye, e drejta e votës mund të kërkojë edhe ndryshime kushtetuese.

Për sa i përket buxhetit, dua t'ju informoj, ashtu si edhe herën e kaluar, se janë duke u mbyllur konkurrimet për sa i përket Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe ndërkaq jemi duke punuar me aktet nënligjore për sa i përket ligjit të Fondit të Zhvillimit të Diasporës dhe për krijimin e qendrave të votimeve në diasporë. Ndërkaq, po punojmë ngushtësisht me qeverinë e Kosovës, por kemi nisur edhe marrëveshje me Maqedoninë dhe me Malin e Zi, pra me dy fqinjët tanë të rëndësishëm, për çështjen diasporës. Ne e konsiderojmë se kemi një diasporë.

Për sa i përket votë së shtetasve ne jemi duke punuar fort, por do të jem i rezervuar për

Mimi Kodheli – Urdhëroni!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër!

Në fakt, ky është një dokument që ne e kemi diskutuar, por meqenëse sot vjen në variantin e konsoliduar, duke falënderuar edhe zonjën Bushka, për punën që ka bërë, kam vetëm dy komente.

Përmendni ngritjen e qendrave të kulturës në diasporë, sipas legjislacionit të ri, në bashkëpunim me shtetin e Kosovës. Pse pikërisht vetëm kjo me Kosovën, ndërkohë që ne kemi miratuar se qendrat e kulturës do të ngihen në shumë ambasada

Së dyti, për pjesën e rishikimit të ligjit për shtetësinë këtu thuhet, me të drejtë, se kjo vjen edhe si një nevojë e shqetësimeve që kanë shtetasit shqiptar që vijën nga jashtë vendit, por edhe nga një strukturë e ngritur e UNHCR-së. Mendoj se kjo duhet rregulluar pak, sepse ligji është i miratuar që në vitin 1999 dhe vetë zbatimi i ligjit ka sjellë vështirësi jo vetëm nëpërmjet këtyre elementeve dhe strukturave të përmendura këtu. Kështu që kjo ndoshta vjen si një nevojë për t'iu përshtatur kohës dhe gjithë zhvillimeve, duke pasur parasysh edhe të gjitha flukset migratore gjatë këtyre vjetëve.

Faleminderit!

Vasilika Hysi- Faleminderit, zonja kryetare!

Lidhur me shqetësimin që ngriti ministri Majko për pashtetësinë, është e vërtetë që ka një problem dhe ditën e premte ka një tryezë në Kuvendin e Shqipërisë, ku do të paraqiten gjetjet e bëra nga UNHCR-ja, por dhe nga UNICEF-i lidhur me problematikën e regjistrimit të fëmijëve. Megjithatë, shqetësimin e koleges Gjebrea unë nuk e gjej të pasqyruar në rezolutë, në mënyrë që Kuvendi i Shqipërisë t'u kërkojë institucioneve përkatëse që të adresojnë shqetësimin. Në këtë kuadër do të ishte më me interes që në projektrezolutë të kishte adresime, ku të kërkohej angazhimi i qeverisë për adresimin e problemeve, të cilat prekin një numër të konsiderueshëm shtetasish shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh ndryshimet që janë bërë në ligjin e gjendjes civile para 2-3 vjetësh, në mos gaboj, ka pasur një debat edhe në Komisionin e Ligjeve lidhur me regjistrimin e shtetasve shqiptarë, të cilët kanë ndërruar totalisht emër e mbiemër dhe fëmija ka marrë emër dhe mbiemër të rremë. Pra, një emër dhe mbiemër, i cili nuk ekziston në asnjë nga regjistrat e gjendjes civile në Shqipëri. Ky është një problem serioz, i cili duhet adresuar. Në këtë kuadër, ku me të drejtë e ngriti si shqetësim edhe kolegia Gjebrea, e cila ka qenë koordinatoreja për antitrafikun, ky është një problem për fëmijët që lindin nga dy prindër, që nuk i njeh asnjë në Shqipëri, me emra dhe mbiemra të ndryshëm, që nuk ka si të vërtetohet se fëmija është i tyre. Unë do të sugjeroja të shtohet në rezolutë një rekomandim që Kuvendi i kërkon qeverisë të marrë në konsideratë gjetjet ose konstatimet e studimeve të kryera, këtë duhet të na e thotë ministri Majko, sepse në raportin do ta njohim të premtën, për ta zgjidhur këtë problem.

Mimi Kodheli- Ju falënderoj për sugjerimet tuaja!

Para se t'ia jap fjalën zonjës Hajdari, dua të shtoj diçka. Unë mendoj se kjo rezolutë, pavarësisht se prek interesa të gjera të qytetarëve shqiptarë ose bashkëkombësve tanë, që jetojnë jashtë kufijve të atdheut, nuk është mekanizmi i vetëm i rregullimit ose i ndërhyrjes në shumë ligje që kjo rezolutë afekton. Pa dyshim që të gjitha tryezat janë të mirëpritura, me qëllim që të gjitha problematikat, të cilat rezoluta dhe vetë diaspora i përball, të risjellin në vëmendje amendimet dhe dëshirat e nevojshme të ligjeve, qoftë kur flitet për shtetësinë, nënshtetësinë, qoftë kur flitet për gjendjen civile, qoftë kur flitet për Kodin Zgjedhor e kështu me radhë.

Unë mendoj që pas komentit ose pyetjeve të zonjës Hajdari, ta kalojmë në votim.

Rudina Hajdari- Atëherë, faleminderit, zonja kryetare! Zoti Ministër!

Së pari, projektrezoluta nuk ka ardhur fare për konsultim me opozitën, unë nuk e kam parë, është hera e parë që e shikoj këtë dhe më vjen keq për këtë gjë.

Së dyti, e shikoj si një rast shumë të mirë, është shumë ambicioz për atë që paraqitet dhe kërkon akoma më shumë buxhet për t'u miratuar. Kështu që unë e vlerësoj vullnetin tuaj të mirë, por e shikoj që ministria juaj, por edhe ju si person nuk keni bërë mjaftueshëm këtë vit sa i takon diasporës.

Fakti që ne kaluam ligjin e diasporës ishte një gjë shumë e mirë, por, nga ana tjetër, e shikoj këtë projektrezolutë më shumë letër sesa si një gjë që do të bëhet konkretisht për diasporën.

Shikoj disa pika, që janë vërtet të rëndësishme, siç janë lidhjet me Kosovën, apo krijimi i një televizioni, të cilat janë shumë pozitive, por nuk është bërë asgjë.

Vasilika Hysi - Është krijuar televizioni.

Rudina Hajdari- Kur është krijuar?

Vasilika Hysi- TVSH-ja ka 13 kanale, Rudi. TVSH 3-shi është vetëm për shqiptarët jashtë vendit.

Rudina Hajdari- Më fal, mos ndërhyini, sepse e di që e keni nga dëshira për të na treguar dhe për të mësuar shumë, por mos kini merak për këtë pjesë, pasi jemi të edukuar dhe i kuptojmë gjërat më mirë sesa ju.

Këtu thotë: "krijimi i një kanali televiziv". Është leximi korrekt apo jo? Kështu që mendoj se duhet të bëjmë akoma më shumë për sa i përket bashkëpunimit më të fortë me Zërin e Amerikës, sepse jepet vetëm një herë në orën 6 të pasdites në një nga televizionet shqiptare.

Ngritja e qendrave të kulturës mendoj se është një gjë komplet sipërfaqësore dhe nuk do të sjellë shumë për diasporën. Diaspora ka nevojë të bashkëpunojë më shumë me qeverinë shqiptare dhe duhet t'u japim sa më shumë indicie atyre që të kthehen në Shqipëri, sepse, siç e dini shumë mirë, një nga problemet që kemi masivisht në Shqipëri, është largimi i shqiptarëve drejt Europës, drejt Amerikës apo drejt vendeve perëndimore dhe kjo është një gjë që ne duhet ta shikojmë me seriozitet dhe të gjejmë mundësinë, ndoshta edhe bashkëpunim me bizneset, për hapjen e vendeve të punës, në mënyrë që ata të kthehen në Shqipëri. Pra, duhet të punojmë më shumë për të arritur disa objektiva, të cilat janë frytdhënëse dhe janë realisht të dobishme për diasporën jashtë Shqipërisë. Këto janë letra, që, për mendimin tim, janë të bukura kur i shikon, kanë fjalët e duhura, por që nuk merren në konsideratë nga opozita dhe, do të jemi prapë bashkë, do të vini edhe vitin tjetër dhe do të shikojmë që do të bëni shumë pak nga këto që janë shkruar në këtë projektrezolutë.

Unë nuk e kam problem, do ta miratoj projektrezolutën dhe do të jap votën time, por ne këtu do të jemi dhe asgjë nuk do ndodhë.

Ju falënderoj shumë për praninë tuaj, por unë uroj sinqerisht që ne të punojmë fort për diasporën, sepse është një numër i madh shqiptarësh jashtë Shqipërisë dhe kemi shumë nevojë për ta.

Mimi Kodheli – Sa për të sqaruar kolegen Hajdari. Kolegia ka munguar në komisionet e mëparshme, por materiali është shpërndarë dhe në respekt të opozitës dhe të protestës së nënkryetares së komisionit, zonjës Gjoshaj, është shtyrë diskutimi i materialit që është shpërndarë atë ditë në komision. Materialet, drafte të punuara dhe të ripunuara, kanë qenë në emaillet tuaja respektive. Kështu që unë besoj se ka qenë e mjaftueshme koha për të marrë opinionet e opozitës, vëzhgesat dhe gjithçka tjetër të vlefshme, që pa dyshim do të ishte pjesë e rezolutës nëse do të kishim një *feedback* nga kolegu dhe kjo është lehtësisht e vërtetueshme.

Nga ana tjetër, e vlerësoj impenjimin e koleges Hajdari dhe sigurisht mund të reflektojmë nëse ka pasur diçka nga opozita.

Nuk është në stilin tim të punës të komentoj atë çfarë thonë të tjerët, por unë mendoj që qendrat kulturore e kanë mbajtur fort shqiptarizmin, të paktën në një shekull e më shumë, të njohjes së rrugëve të mërgimit të shqiptarëve. Ata e kanë mbajtur shqiptarizimin, ata i kanë ruajtur traditat, gjuhën dhe në ato qendra kulturore kanë marrë pjesë figurat emblematike dhe historike të Shqipërisë, duke filluar që nga Fan Noli dhe deri te më i fundit që ka kontribuar aty.

Edhe diçka tjetër, fillimisht “carta canta” thonë latinët, pra duhet shkruar në kartë pastaj duhet zbatuar. Ne nuk jemi këtu për të paragjykuar, por për të hedhur në kartë gjëra të drejta dhe të mira. Pa dyshim që ndaj të njëjtin mendim me zonjën Hajdari, do të vijë një vit më mbrapa, uroj që ministër të jetë zoti Majko, dhe pas një viti ju të mund të raportoni, me seriozitetin që ju karakterizon, se çfarë kemi bërë me këto kartat që do të miratojmë sot.

Zonja Gjermani ka diçka për të thënë.

Eglantina Gjermani- Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, Ministër!

Edhe unë falënderoj zonjën Bushka, për faktin që ky dokument ka marrë një formë të plotë projektrezolute, e cila është një bilanc i punës së ministrit të Diasporës dhe i punës së Komisionit të Politikës së Jashtme, sepse brenda një viti kemi hedhur hapa të rëndësishëm, kemi miratuar një strategji, kemi miratuar një projektligj dhe një ligj. Domethënë, janë bërë disa hapa të rëndësishëm për ta institucionalizuar këtë ministri, për t’i dhënë asaj hapësirën dhe mundësinë për të kryer misionin e saj.

Gjithashtu, e shoh si një bilanc pune, por edhe si një reflektim për çfarë duhet bërë. Të gjitha angazhimet që janë këtu në projektrezolutë për vitin 2018 janë ambicioze dhe ne jemi të

ndërgjegjshëm për këtë, ku disa janë bërë brenda vitit 2018 dhe disa janë për në vazhdim. Këtu dua të theksoj patjetër të drejtën e votës, për të cilën ne dhe të gjithë qytetarët shqiptarë kudo që jetojnë janë të interesuar.

Ne si komision, sidomos Komisioni i Diasporës dhe Emigracionit duhet të luajnë një rol më të rëndësishëm dhe proaktiv edhe në Komisionin e Reformës Zgjedhore, edhe në monitorimin e kësaj rezolute. Këtu thuhet gjithashtu që brenda këtij vitit është marrë vendimi i Këshillit të Ministrave për të organizuar samitin e dytë të diasporës. Edhe këtu gjej rastin të ritheksoj rolin e Komisionit për Politikën e Jashtme dhe të nënkomisionit për të qenë më proaktiv dhe më të përfshirë në të gjitha angazhimet që përmban kjo rezolutë. Them se kemi goxha sfida përpara dhe jemi të gatshëm t'i përballojmë, duke u bazuar në gjithçka të hartuar apo të miratuar në kuadrin ligjor dhe të politikave për t'i zbatuar.

Ju uroj sukses!

Sërish rezoluta, ashtu siç janë miratuar ligjet për diasporën, do të ketë angazhimin dhe mbështetjen e opozitës. Ky është supozimi im dhe shpresoj të jem e saktë.

Mimi Kodheli – Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Zonja kryetare, e vlerësoj shumë komentin tuaj, por doja të shtoja vetëm një gjë, sepse edhe unë jam dakord me ju që qendrat kulturore janë shumë të domosdoshme, por duhet të jemi realistë dhe të reflektojmë thellë për faktin se akoma nuk kemi ambasada me kushte normale. Unë kam jetuar gjatë në emigracion, kështu që e di shumë mirë se si funksionojnë ambasadat jashtë Shqipërisë. Pikërisht aty fillon kultura jonë, pra kur ambasadat të kenë personel dhe kushte normale, vetëm atëherë mund të kemi qendra kulturore, por këto kërkojnë buxhet dhe seriozitet, gjëra që, në fakt, mungojnë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Hajdari!

E vlerësoj opinionin tuaj, sigurisht ju jeni shumë më e re se unë, por ju se siguroj kushtet e ambasadave para 20 vjetëve nuk kanë qenë këto të sotmet. Ky është një proces dhe ne jemi duke i përmirësuar. Jam absolutisht dakord me ju që paratë për të pasur ambasada dinjitoze nuk mjaftojnë. Kemi pasur këtu për dëgjuesë disa ambasadorë të rinj me të cilët kemi diskutuar e ridiskutuar për hapjen e ambasadave të reja në botën latine, pra në Amerikën e Jugut, për shtimin e personelit dhe për përmirësimin e kushteve. Ne, si Komision për Politikën e Jashtme, jemi këtu dhe kur të vijë buxheti do ta kërkojmë me forcë dhe nuk do ta kalojmë buxhetin nëse nuk plotësohen kërkesat tona. Dua të them se e kemi aq të drejtë sa të ngremë karton pro ose kundër.

Nëse nuk ka gjë tjetër, unë ju falënderoj!

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Duke marrë në konsideratë komentet e kolegeve të Gejbrea dhe Hysi sa i takon çështjes së problemeve të shtetasve me regjistrimet, mendoj se është e udhës ta reflektojmë në tekstin e rezolutës dhe, për këtë arsye, do të ripropozoj një riformulim në paragrafin e fundit të faqes 4.

A ta lexoj për efekt regjistrimi, zonja kryetare?

Mimi Kodheli – Po.

Klotilda Bushka – Kam dy përmirësime në kuadër të sugjerimeve të kolegeve si më poshtë:

Mendoj që paragrafi i tretë nga fundi të riformulohet në këtë formë: “Paraqitjen dhe/ose ndërmarrjen e nismave të nevojshme nga organet kompetente për rishikimin e ligjit “Për shtetësinë shqiptare” dhe të kuadrit ligjor përkatës për t’iu përgjigjur shqetësimeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe fenomenit të pashtetësisë, të ngritur nga struktura përgjegjëse e OKB-së për këtë çështje, zyra e UNHCR-së në Tiranë”. Ky është formulimi dhe besoj se i përgjigjet shqetësimeve që ngrenë koleget.

Se dyti, do të doja të bënim një riformulim në një paragraf para këtij, pasi ka të bëjë me detyrimet ligjore për ndihmën juridike sipas ligjit që sapo kemi miratuar, me qëllim që ta përshtatim me të.

Riformulimi të jetë i tillë: “Nxitjen e organeve të vetëqeverisjes vendore për të mundësuar aksesin e diasporës dhe emigrantëve, me qëllim shkurtimin e distancave administrative në shtresën e popullsisë që nuk jeton brenda vendit”.

Mimi Kodheli – Kush është dakord me projektrezolutën për reformën e politikës së jashtme për diasporën?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit për prezencën tuaj në mbledhjen e komisionit.

Ju uroj ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

